

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.104/2016	Data: 23.12.2016	

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 12.2 pika (d) dhe nenit 17 pika (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, si dhe neni 23 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/233, në mbledhjen e mbajtur me 23/12/2016. Ministrisë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë me datë 14.10.2016, lëshon raportin nga monitorimi i zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Istogut ku ceket së shqyrtoj raportin nga monitorimi i zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Istogut, dhe mori këtë:

V E N D I M

- Bëhet shfuqizimi i Vendimeve në fuqi për mbrojtjen e këtyre monumenteve natyrore (Vendimin 01Nr.65/08 të datës 24.12.2008) për shkak të dëmtimit nga erërat të ndërpritet mbrojtja e këtyre monumenteve:
 - Trungu i Blirit të kuq (Tilia sp.) në Istog të Poshtëm,
 - Trungu i Blirit të argjend (Tilia sa.) në Kaliqan dhe
 - Trungu u rrënjës (Quercus robur) në Gurrakoc.
- Obligohet Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të lejen asgjësimin e monumenteve në harmoni me ligjin për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233, neni 23.
- Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe për zbatimin e tij është përgjegjës: Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHVE
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna

Nr. 01-039-16 Data 29.12.2016

Br.

ISTOG-ISTOK



Kryesuesi i Kuvendit,
 Hazbi Bajra